



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS SHTËRPCË

Numri i lëndës: 2018:020672

Datë: 10.07.2020

Numri i dokumentit: 01044380

P.nr.101/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEGA NË SHTËRPCË, gjyqtari Habib Zeqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Kreshnike Zymberi, në çështjen penale kundër të akuzuarve: R.K dhe B.K, për shkak të vepraës penale në bashkëkryerje sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1131-7/16 të datës 29 maja 2017 në prani të përfaqësueses së akuzës-prokurorit të shtetit, Valdet Avdiu dhe të akuzuarve si dhe ligjor F.Q, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 10 korrik 2020 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- 1. R.K**, i lindur më ... në Prishtinë, nga i ati B... dhe e ëma S... e gjinisë M..., me vendbanim në, i martuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës;
- 2. B.K**, i lindur më ... në ..., nga i ati B... dhe e ëma J... e gjinisë D..., me vendbanim në ...ë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Kosovës;

JANË FAJTORË

Sepse me datën 17.07.2016 rreth orës 01:20 në lagjen ...e në Shtërpcë të pandehurit kanë sulmuar personat zyrtar dhe atë policët- të dëmtuarit M.I dhe K.I, derisa ata ishin në kryerjen e detyrës zyrtare në atë mënyrë që gjersa po patrullonin me veturë e policisë kishin sinjalizuar që të ndalonin të pandehurin R... i cili e drejtonte veturën e tij "Fiat Tipo", ngjyrë të kuqe, me targa, por i njëjti nuk ishte ndaluar ashtu që me të arritur tek shtëpia e tij në bashkëveprim me të pandehurin e dytë- babin e tij B.... kishin kanosur dhe sulmuar të dëmtuarit por sipas ekspertizës mjekoligjore nuk i kishin shkaktuar lëndime;

-Me këtë në bashkëkryerje sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 50, 51, 73 të KPRK-së si dhe nenin 365 të KPRK –së, të akuzuarve u shqipton:

DËNIM ME KUSHT

1. Të akuzuarit **R.K** i vërtetohet dënim me burgimi në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej një (1) viti, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm nuk kryen veprë tjetër penale.
2. Të akuzuarit **B.K** i vërtetohet dënim me burgimi në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej një (1) viti, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm nuk kryen veprë tjetër penale.

Gjykata mund ta revokoj dënimin me kusht për të pandehurit, nëse të njëjtit gjatë kohës së verifikimit kryejnë ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor secili të paguaj shumat nga 50 € dhe atë: për shpenzimet lidhur me paushallin gjyqësor nga 20 € si dhe për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit nga 30 €, të gjitha në afat prej pesëmbëdhjetë (15) dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjimit, në të kundërtën do të iniciohet procedura përmbare.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr. 1131-7/16 të datës 29 maj 2017 ka ngarkuar të akuzuarit R... dhe B.K., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më 10 korrik 2020, në të cilën të akuzuarit, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, e kanë pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën janë akuzuar.

Meqë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjykata pas marrjes së mendimit të Prokurorit të Shtetit ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së pasi të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.H i datës 09 prill 2017, raportet mjekësore nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Shtërpcë të datës 17 korrik 2016, fotografitë dhe prova tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi që ka të bëjë me datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese për të dy të akuzuarit se në shqyrtimin fillestar kanë pranuar fajësinë dhe nuk rezultoi se ndaj të njëjtit të jenë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë. Andaj këto rrethana kanë qenë arsye që gjykata me rastin e shqyrtimit e dënimeve edhe pa ekzekutimin e tyre konsideron se mundet të arrihet qëllimi i

dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së. Dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të akuzuarve, mund të revokohet nëse të akuzuarit gjatë periudhës së verifikimit kryejnë veprë të re penale (Neni 53 i KPRK-së).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe shpenzimet e procedurës është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË

P.nr.101/17 datë 10 korrik 2020

Bashkepuntorja Profesionale,
Kreshnike Zymeri-Beqiri

Gjyqtari,
Habib Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpçë.